

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual **Faton Ademi**, në çështjen juridike të paditëses: dlië Mirëqënies Sociale- Departamenti I Administratës Pensionale të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë Divizioni për Përfaqësime Gjyqësore: zyrtarja ligjore : kundër të paditurit: Rr. nr. Mitrovica, baza e kontestit: Pasurim i Pa Bazë, pas mbajtjes së seancës kryesore me datë: 14.06.2017 bie këtë:

AKTGJYKIM

- **OBLIGOHET** e paditura: nga Mitrovica që t'ia kthej paditëses: Ministrisë së Punës dhe Mirëqënies Sociale- Departamentit të Administratës Pensionale shumën prej 112 euro në emër të pasurimit të pabazë në llogarinë rrjedhëse të M.P.M.S nr. brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm dhe
- **OBLIGOHET** i Padituri që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajë paditëses shumën prej 15 euro, ndërsa në emër të përpilimit të aktgjykimit t'ia paguajë gjykatës shumën prej 15 euro të gjitha këto brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm

Arsyetim

Paditesja ka parashtruar në gjykatë padi për pasurim të pa bazë kundër të paditurit, dhe ka kërkuar nga gjykata që ta obligon të paditurin që shumën prej 112 euro të terhequr pa bazë, t'ia kthej paditëses.

Gjykata me datë: 16.05.2017 ka caktuar seancën kryesore në të cilën prezantuan: përfaqësuesi i paditëses, ndërsa nuk ishte present e paditura e ftuar me rregull.

Në seancë përfaqësuesja e paditëses deklaroi: se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiisë I propozoi gjykatës që kërkesëpadiinë e paditëses ta aprovon sit ë bazuar duke e urdhëruar të paditurin që shumën prej 112 euro t'ia kthej në llogarinë rrjedhës numër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqënies Sociale si dhe shpenzimet gjyqësore të gjitha këto në afat 7 ditor nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e paditurës deklaroi: në tërësi si nëpadi dhe deklaratimet e mëhershme.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike në seancën kryesore administroi këto prova: akti përcjellës I dt.31.03.2015, regjistri për kthimin e mjeteve financiare, raporti I vdekjes I dt.22.11.2013, lista e personave për llogari e dt.24.12.2010, kërkesa e dt.24.10.2010, formulari mbi burimin e fondeve I dt.24.10.2010, kopja e letërnjoftimit të të ndjerës , letërnjoftimi I të paditurës, formulari I llogarisë I dt.27.01.2006, vërtetimi I dt.27.01.2006, fletërheqja nga për

Gjykata provat e administruara i vlerësoi një nga një dhe të gjithë sëbashku e në raport me njëra tjetrën dhe nga të njëjtat vërtetoi këto fakte:

Se e padituri ka tërhequr pensionin prej 112 eurove, pension ky i dedikuar për pensionisten tani të ndjerën: , këtë fakt gjykata e vërteton në bazë të: fletërheqjes lëshuar nga Banka për Biznes me datë: 27.11.2013, poashtu ky fakt vërtetohet edhe në bazë të regjistrit për kthimin e mjeteve për pensionin bazë për muajin e XI 2013.

Se i ndjeri: ka vdekur me datë: 19.10.2013, këtë fakt gjykata e vërteton në bazë të raportit të vdekjes së pensionistit I dt.22.11.2013.

Sa i përket provave tjera të njëjtat nuk përbëjnë ndonjë relevancë të theksuar më tepër kanë të bëjnë me hapjen e llogarisë për personin e ndjerë, pastaj autorizimin se në vend të tij paratë mund t'i tërheq e paditura, kopjet e letërnjoftimeve kanë të bëjnë me vërtetimin e identitetit të të paditurës dhe personin tani të ndjerë.

Gjykata vendimin e saj e mbështet në dispozita materiale të LMD-së më konkretisht neni 194 citoi:

1. Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atëqë ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur.
2. Fjala pasurim po ashtu përfshinë përvetësimin e fitimit përmes shërbimeve.
3. Detyrimi për kthim ose kompensim po ashtu lind edhe nëse një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket.

Në rastin konkret e padituri është pasuruar pa bazë pasi ka tërhequr pension në emër të të ndjerit për muajin kur i ndjeri veç se kishte vdekur dhe se ky pension nuk i takon, andaj sipas rregullave të kthimit këto mjete e paditura obligohet t'i kthej.

Udhëzimi Administrativ 14/2009 e sqaron në mënyrë shumë të qartë këtë situatë .

Në bazë të Udhëzimit Administrativ 14/2009 në nenin 2 ceket se pensioni nuk iu paguhet personave të vdekur; në nenin 2 cekete se nëse pensionisti vdes pensioni nuk duhet t'i paguhet prej fillimit të muajit të ardhshëm, sin e rastin konkret pensionisti ka vdekur në fund të muajit mars, pensioni nuk duhet të paguhet për muajin prill.

Në nenin 4 ceket se nëse një person tërheq mjete pas vdekjes së pensionistit kjo do të konsiderohet mashtrim- pasurim I pa bazë dhe personi duhet ta kthej shumën e marrë, ndërs kundër personit të tillë do të meren masa ligjore.

Si masë ligjore sipas vlerësimit të gjykatës konsiderohet ngritja e padisë kundër atij personi duke kërkuar kthimin e mjeteve dhe pagesën e shpenzimeve procedural.

Pra në raport me dispozitën ligjore dhe ato të udhëzimit administrativ, I padituri ka tëhequr pension në emër të të vdekurit për kohën sa personi ka qenë i vdekur e I cili pension nuk i takon.

Në lidhje me shpenzimet procedural gjykata vendosi konform nenit 452 të LPK-së si dhe Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C.Nr.210/2015 datë: 14.06.2017

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOBNDNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
MITROVICË - MITROVICA

GJYQTARI
Faton Ademi

Më
Dana _____ 20_____

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 7 ditor nga dita e pranimit së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – nëpërmjet kësaj gjykate.